

VENDIM
Nr. 92, datë 17.2.2021

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 55, DATË 27.1.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PARAQITJES, FORMËS DHE
SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË GRADAVE, SIMBOLEVE, UNIFORMAVE DHE
SHENJAVE TË POLICISË SË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 62, 97 e 98, pika 1, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 55, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) në pikën 5.3, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “dh/1”, me këtë përmbajtje:
“dh/1) Shenja e krahut e Drejtorisë së Antiterrorit”;

b) në lidhjen nr. 4, të albumit, shtohet shenja dalluese për Drejtorinë e Antiterrorit, sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga programi buxhetor “Policia e Shtetit”.

3. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LIDHJA 1

a) Lidhja 4, pika 5.3, shkronja “dh/1”
“Shenjë krahut e Drejtorisë së Antiterrorit”


Mburojë (shqyt) e ndarë në dy pjesë: Shqyta e parë me sfond ngjyrë blu të errët e kornizuar me ngjyrë të artë. Shqyta e dytë me sfond ngjyrë të kuqe, në mes është vendosur Shqiponjë dykrenore me krahë të hapur anash, në gjoksin e saj një mburojë (shqyt), me motive, në qendër dielli. Mbi dy krenoret të Shqiponjës lart, është vendosur Përkrenarja në profil djathtas, Shqiponja në kthetrën e djathtë një shpatë e drejtë me dy tehe dhe në kthetrën e majtë një degë ulliri. Brenda shqytës së parë lart, me sfond blu të errët, ka të shkruar me germa kapitale fjalën “ANTITERRORI”, me ngjyrë të artë, ndërsa në pjesën e poshtme ka të shkruar me germa kapitale fjalët “POLICIA E SHTETIT”, me ngjyrë të artë.